



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE

Analizë e shkurtër  
**Qytetarët dhe qeverisja urbane në komunat e rajonit të Prizrenit**  
*Dhjetor 2018, Prizren*

## PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje ekzekutive.....	2
II. Pse duhet përfshirë qytetarët në planifikim dhe qeverisje urbane .....	3
III. Korniza ligjore për pjesëmarrje: nga transparencja te bashkëqeverisja urbane .....	5
IV. Analizë e gjendjes në komunat e rajonit të Prizrenit .....	8
V. Niveli i pjesëmarrjes qytetare në hartimin e dokumenteve hapësinore .....	10
VI. Grupet e nënpërfaqësuar në komunitet .....	11
VII. Performanca e komunave në krijimin e mekanizmave dhe nxitjen e bashkëqeverisjes .....	11
VIII. Roli i organizatave të shoqërisë civile në nxitjen e bashkëqeverisjes .....	12
IX. Përkrahja nga niveli qendror dhe donatorët.....	13
X. Rekomandime .....	14
XI. Burime .....	15
XII. Për EC Ma Ndryshe.....	15

## Përmbledhje ekzekutive

Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban. Planifikimi urban është një proces dinamik që synon përmirësimin e mirëqenies së njerëzve duke krijuar vendbanime më të përshtatshme, më të shëndetshme, më të barabarta, më efektive dhe më tërheqëse për të tashmen dhe gjeneratat e ardhshme. Në shoqëritë demokratike presim që zëri i qytetarit të përfaqësohet në proceset e vendimmarrjes për qytetin përmes përfaqësuesve të zgjedhur në këshillat e qytetit. Në realitet, këta përfaqësues në të shumtën e rasteve nuk e përfaqësojnë zërin e grupeve të marginalizuara, të cilat janë jashtë proceseve politike. Për këtë arsye, duhet të krijohen mundësitë që qytetarët të kontribuojnë dhe të komunikojnë aktivisht që t'i kthejnë proceset e ndryshimeve urbane në favor të përmirësimit të jetës së tyre në qytet.

Në një hulumtim të EC Ma Ndryshe dhe Pro-Planning të vitit 2016, në pyetjen se si e vlerësojnë pjesëmarrjen e publikut, 77% e të intervistuarve kanë deklaruar se ajo është e pamjaftueshme, ndërsa vetëm 23% deklarojnë se ajo është e mirë. Arsyet kryesore të pjesëmarrjes së pamjaftueshme dalin që janë: Mungesa e interesimit të publikut për të marrë pjesë në takimet e organizuara nga komuna dhe Mosinformimi adekuat dhe mungesa e q- sjes proaktive nga ana e komunës. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me akt të veçantë respektivisht me Udhëzimin Administrativ për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor ka përcaktuar përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, njoftimit publik, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të debatit

publik, trajtimin e peticioneve, si dhe përgatitjen e raportit shqyrtues të propozimeve dhe vërejtjeve publike. Megjithatë, në komunat e rajonit të Prizrenit, publiku është pjesërisht i informuar sa i përket akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban. Informatat janë të pakta mbi rregulloret ekzistuese për planifikim urban, planet, strategjitë, kriteret e kufizimet dhe procesin e marrjes së lejeve.

Nivel të lartë të përjashtimit social nga proceset e planifikimit hapësinor në komunat e rajonit të Prizrenit konstatojnë edhe aktivistët e shoqërisë civile, ndërsa grupet më të privuara janë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, pakica etnike dhe të moshuarit. Aktivistët e shoqërisë civile janë kritikë edhe ndaj faktit që komunat nuk marrin mundin të dalin jashtë kornizave konvencionale të organizimit të diskutimeve publike, duke u kufizuar në metoda standarde të njoftimit. Në anën tjetër, bashkëpunimi mes komunave (autoriteteve të planifikimit) dhe organizatave të shoqërisë civile në komunat e rajonit të Prizrenit nuk është në nivelin e duhur. Rëndom zyrtarët e planifikimit hapësinor në komuna presin angazhim më të madh të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa këta të fundit shprehin skepticizëm në raport me rezultatet e prekshme që mund të arrihen nga ky bashkëpunim.

EC Ma Ndryshe është e angazhuar një kohë të gjatë në nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procese të vendimmarrjes në nivel lokal, më theks në planifikim dhe zhvillim urban. Organizata monitoron në vazhdimësi këto procese dhe ofron alternative të politikave publike, si dhe rekomandon metodologji dhe mekanizma alternativë për të nxitur gjithëpërfshirjen në planifikimin dhe zhvillimin e mjedisit jetoësor në komunat e Kosovës. EC Ma Ndryshe rekomandon këto veprime si më prioritare dhe urgjente: 1. Komunat duhet të sfidojnë veten duke futur në përdorim edhe metoda kreative të informimit publik dhe përfshirjes së tyre në procese të planifikimit hapësinor, 2. Qytetarët duhet vazhdimisht të informohen mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në

procese të planifikimit hapësinor në mënyrë që të jetë në gjendje të japin kontribut substancial dhe të kuptojë përfitimet e tyre nga përfshirja në planifikim, 3. Kur vendoset të zhvillohet ndonjë proces i planifikimit hapësinor, paralel me buxhetin për hartim/zbatim, duhet të alokohet edhe buxheti për pjesëmarrjen publike në atë proces, në mënyrë që kjo të mos pamundësojë pjesëmarrjen e nevojshme dhe të kënaqshme, 4. Duhet të përmirësohet performanca e komunave në zbatim të planeve në mënyrë që të kthehet besimi i qytetarëve dhe motivimi i tyre për pjesëmarrje, 5. Organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen më shumë për të prioritetizuar çështjet e planifikimit hapësinor dhe të nxisin mobilizimin qytetar për gjithëpërfshirje në qeverisje urbane.

### **Pse duhet përfshirë qytetarët në planifikim dhe qeverisje urbane**

Për Ali Madanipour-in, qyteti “ofrohet dhe menaxhohet nga autoritetet publike”, dhe “shfrytëzohet dhe ndahet nga të gjithë anëtarët e bashkësisë”. Ai është “bota e përbashkët institucionale dhe materiale, hapësirë e ndërmjetme që lehtëson bashkëpresencën dhe rregullon marrëdhëniet ndërpersonale.<sup>1</sup> Si hapësirë që ndahet barabartë nga të gjithë anëtarët e bashkësisë, dhe si produkt i demokracisë, qyteti poashtu përkufizon dhe shtron rregulla të mirësjelljes dhe respektit për tjetrin.

Konceptet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes janë dy koncepte cilësore që shfrytëzohen shpesh në diskutet e fushës së planifikimit dhe zhvillimit. Programi i UN Habitatit e përkufizon qytetin gjithëpërfshirës si qytet që promovon zhvillimin me drejtësi. Qyteti gjithëpërfshirës “është vendi ku të gjithë, pavarësisht mundësive të tyre ekonomike, racës, gjinisë, etnisë apo fesë, mund të marrin pjesë plotësisht në të gjitha mundësitë shoqërore,

ekonomike dhe politike që i ofron qyteti”. Sipas këtij programi drejtësia është një nga tri shtyllat e qëndrueshmërisë, dhe më e rëndësishmja që është thelbësore në krijimin e të ardhmës urbane të qëndrueshme dhe të përbashkët. (UN-Habitat, 2001)

Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban. Qasja fillestare te projektimi gjithëpërfshirës është që të binden anëtarët e bashkësisë që të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e strategjive të herëshme dhe planifikimin e projekteve për qytetin e tyre. Me anë të përfshirjes së gjithë bashkësisë, problemet e vërteta, burimi i tyre dhe zgjidhjet potenciale parashtrihen dhe diskutohen në punëtori të ndryshme.

Projektet dhe idetë që rrjedhin nga një punë e tillë me bashkësinë zakonisht janë të lidhura me kontekstin, dalin nga nevojat dhe kultura e bashkësisë dhe mjedisi në të cilin ato ekzistojnë. Falë pjesëmarrjes të madhe, bashkësia do të kenë një sens të fortë pronësie dhe përkushtimi ndaj projektit.

Në manualin “Qyteti gjithëpërfshirës” Goltsman and Iacofano e paraqesin planifikimin gjithëpërfshirës të qytetit si zgjidhje “të bazuar në politikat e ndjeshme ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe kulturore që ua lejojnë të gjithëve të përmirësohen ekonomikisht bashkë me përmirësimin e hapësirës ku jetojnë”. Ata theksojnë se qytetet kanë nevojë për mënyrë planifikimi që e njeh të drejtën e përfshirjes të secilit njeri në proceset zhvillimore: “përmes pjesëmarrjes, njerëzit mund t’i japin formë mjedisit të tyre për t’i përmbushur nevojat e tyre.” Grupet me të prekura zakonisht rrallë

<sup>1</sup> Madanipour, Ali, (2003) *Public and Private Spaces of the City*, Routledge

përfshihen në proceset planifikuese meqë u mungojnë shkathtësitë, dija dhe informata. Kjo krijon pastaj rrezikun e mospërfshirjes së nevojave të tyre në planifikimin urban, që më tutje pasqyrohet me keqësimin e mjedisit të tyre jetësor. Për t'i adresuar këto problem, autorët e lartëpërmendur sugjerojnë procesin e projektimit gjithëpërfshirës të bazuar në tri kategori: funksionalitet (projektim që ngërthen të gjithë tipet e individëve), ndjeshmëri kontekstuale (harmonia me mjedisin rrethues) dhe impakt të drejtësisë për të "zvogëluar impaktin shoqëror dhe njerëzor tek anëtarët më të prekur të shoqërisë".<sup>2</sup>

Planifikimi urban është një proces dinamik që synon përmirësimin e mirëqenies së njerëzve duke krijuar vendbanime më të përshtatshme, më të shëndetshme, më të barabarta, më efektive dhe më tërheqëse për të tashmen dhe gjeneratat e ardhshme. Planifikimi i tillë iu mundëson vendimmarrësve, bizneseve, shoqërisë civile por edhe grupeve të qytetarëve që të luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e komuniteteve që përmirësojnë jetesën e njerëzve. Pra, planifikimi i mirë, ndihmon krijimin e komuniteteve që ofrojnë zgjidhje më të mira për atë se ku dhe si duam të jetojmë. Planifikimi iu ndihmon komuniteteve që të përfytyrojnë të ardhmen e tyre, duke gjetur baraspeshën e duhur mes zhvillimeve të reja dhe shërbimeve thelbësore, mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimit që sjell risi.<sup>3</sup>

Qytetet duhet të prodhohen duke pasur parasysh parimin e barazisë dhe drejtësisë për të gjithë dhe kjo nënkupton se duhet të jenë vende të qasshme, të krijuara dhe të menaxhuara përmes proceseve gjithëpërfshirëse. Pjesëmarrja qytetare është komponenta thelbësore e

---

<sup>2</sup> Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces, MIG Communications).

<sup>3</sup> Përkufizim i Shoqatës Amerikane të Planifikimit, i publikuar në:  
<https://www.planning.org/aboutplanning/whatisplanning.htm>

proceseve gjithëpërfshirëse, e cila ia mundëson qytetarit që të kontribuojë në vendimmarrje për qytetin. Kur flasim për vendimet që merren gjatë procesit të planifikimit të qytetit, në një proces gjithëpërfshirës të planifikimit, krahas ekspertëve të fushës, janë pikërisht qytetarët jo-ekspertë që duhet të përfshihen, meqë një qytet popullohet nga banorë jo-ekspertë, të cilët, me përvojat e përditshmërisë, mund të kontribuojnë në identifikimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve në qytet.<sup>4</sup>

Në shoqëritë demokratike presim që zëri i qytetarit të përfaqësohet në proceset e vendimmarrjes për qytetin përmes përfaqësuesve të zgjedhur në këshillat e qytetit. Në realitet, këta përfaqësues në të shumtën e rasteve nuk e përfaqësojnë zërin e grupeve të marginalizuara, të cilat janë jashtë proceseve politike. Për këtë arsye, duhet të krijohen mundësitë që qytetarët të kontribuojnë dhe të komunikojnë aktivisht që t'i kthejnë proceset e ndryshimeve urbane në favor të përmirësimit të jetës së tyre në qytet. Për më shumë, është e nevojshme që të emancipohet një qytetari aktive, përkatësisht një qytetar aktivist<sup>5</sup> i cili, më parë se të presë prej institucioneve që ta bëjnë ndryshimin, me përkushtimin që e ka ndaj komunitetit dhe mjedisit urban, e udhëheq ndryshimin në mënyrë të pavarur dhe e shtyn komunitetin të përfshihet aktivisht në proceset vendimmarrëse.<sup>6</sup>

### **Korniza ligjore për pjesëmarrje: nga transparenca te bashkëqeverisja urbane**

E drejta e pjesëmarrjes në procese të vendimmarrjes fillon me transparencën. Kushtetuta e Kosovës ofron bazë të qëndrueshme juridike sa i përket transparencës së institucioneve duke përfshirë edhe

---

<sup>4</sup> Urban trends, BMW Guggenheimlab, <http://www.bmwguggenheimlab.org/100urbantrends/#!/new-york-city>

<sup>5</sup> Po aty

<sup>6</sup> Po aty

transparencën në komuna. Neni 40 dhe 41 i Kushtetutës garantojnë të drejtën e qytetarëve për të ndarë dhe marrë informata, përkatësisht të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet e institucioneve publike dhe të organeve të pushtetit shtetëror.<sup>7</sup> Në përputhje me Kushtetutën e vendit, më tej janë hartuar dhe miratuar një numër i ligjeve dhe akteve tjera nënligjore me të cilat përcaktohen të drejtat e qytetarëve në procese me interes publik në nivel lokal dhe në të njëjtën kohë janë përcaktuar edhe obligimet që kanë institucionet qendrore dhe ato lokale në sigurimin e kushteve të nevojshme për të qenë transparent karshi qytetarëve.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike konsiderohet si dokumenti më i rëndësishëm me të cilin synohet të arrihen standardet ndërkombëtare të transparencës. Ky ligj i garanton secilit qytetar të drejtën për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo të pranuar nga institucionet publike. Me këtë ligj rregullohen të gjitha procedurat e nevojshme për qasje në dokumente publike duke filluar nga kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përpunimi i kërkesave dhe lejimi i qasjes në dokumente publike. Më këtë ligj të gjitha institucionet publike obligohen që t'i publikojnë të gjitha dokumentet dhe të kenë një adresë e-maili për komunikim me publikun.<sup>8</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale është ligj bazik për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në Kosovë. Ky ligj parasheh shumë obligime për institucionet e pushtetit lokal ndër të cilat edhe ato që lidhen me transparencën e komunave.<sup>9</sup> Këto obligime mund të trajtohen në disa dimensione.

---

<sup>7</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Kosovës, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

<sup>8</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Dimensioni i parë ka të bëjë me të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitetet e komunës. Ky ligj i obligon komunat që t'i njoftojnë qytetarët mbi mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës shtatë përkatësisht tre ditë pune para datës së mbledhjes. Ky obligim vlen edhe për mbledhjet e komiteteve të Kuvendit të Komunës. Dimensioni i dytë lidhet me obligimin e komunave për organizimin e takimeve publike. Në bazë të kësaj, komunat janë të obliguara që së paku dy herë në vit (njërën në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe të dytën në gjashtëmujorin e dytë të vitit) të mbajnë takime publike në të cilat mund të merr pjesë secili qytetar i komunës përkatëse. Në këto takime përfaqësuesit e komunës janë të obliguar t'i informojnë qytetarët mbi aktivitetet e komunës, ndërkohë që pjesëmarrësit kanë të drejtë të shtrojnë pyetje dhe të paraqesin propozime për zyrtarët e komunës. Krahas kësaj, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës mbi të gjitha rregulloret, planet dhe politikat e komunës me interes të përgjithshëm për qytetarët e komunës.

Dimensioni i tretë ka të bëjë me të ashtuquajturën demokraci të drejtpërdrejtë në të cilën përfshihet e drejta e qytetarëve për peticion, iniciativa të qytetarëve për të propozuar rregullore komunale, referendum dhe për të ndërmarrë iniciativë për largimin e kryetarit të komunës. Dimensioni i katërt parasheh të drejtën e kuvendeve të komunave për themelimin e komiteteve konsultative me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Statusi i këtyre komiteteve është këshillëdhënës dhe anëtarë të këtyre komiteteve duhet të jenë ekskluzivisht qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të komunave përkatëse.

Ligji për vetëqeverisjen lokale në të njëjtën kohë obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës. Me qëllim të lehtësimit të procedurave të hartimit e këtyre

rregulloreve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hartuar një udhëzim të veçantë administrativ për transparencën në komuna. Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të organeve të saj, detyrimin për njoftim publik, konsultimin e publikut mbi politikat komunale etj.<sup>10</sup> Për dallim prej ligjit për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimi Administrativ për transparencën në komuna jep përkufizime më konkrete të obligimeve të komunave dhe adreson përgjegjësinë për ndërmarrjen e veprimeve. Udhëzimi Administrativ për transparencën në komuna obligon komunat që krahas organizimit të së paku dy takimeve publike gjatë vitit, të organizojnë edhe takime shtesë për çështje që lidhen me buxhetin e komunës, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale etj. Komuna duhet t'i njoftojë qytetarët së paku dy javë para mbajtjes së takimit publik dhe atë përmes shpalljeve publike, mediave dhe faqes elektronike të komunës.

Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike është akt që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat tjera që duhet të kenë të gjitha ueb faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave. Këtu përmendet edhe obligimi që institucionet në ueb faqet e tyre të publikojnë një adresë e-maili për komunikim me publikun që në vazhdimësi kontrollohet nga personi përgjegjës, në vazhdimësi të përditësojnë të dhënat e publikuara në ueb faqe, të kenë të zhvilluar dhe të funksionalizuar modulën e kërkimit, etj.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11403>

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11007>

Rregullorja Komunale për Transparencë është akt komunal, i cili duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës në përputhje me Udhëzimin Administrativ për transparencën në komuna. Rregullorja për transparencë synon forcimin e transparencës së organeve të komunës, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet publike të komunës. Në një formë, ajo mund të konsiderohet edhe “adoptim” i Udhëzimit Administrativ për transparencën në komunën përkatëse duke marrë në konsideratë kushtet dhe rrethanat specifike të saj.

Ligji për Planifikimin Hapësinor përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij ligji, si dhe aktivitetet të cilat ndërmerren në planifikim hapësinor dhe rregullim territorial në Republikën e Kosovës. Planifikimi hapësinor dhe rregullimi bazuar në dispozitat e këtij ligji duhet të bazohen në parimin e promovimit të procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndërsektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, pastaj promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor dhe promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor. Ligji parasheh që autoritetet e planifikimit hapësinor para se t'i finalizojnë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor, përmes njoftimit publik ti ftojë qytetarët dhe të zhvillojnë konsultime dhe shqyrtime publike, në mënyrë që të inkurajojnë pjesëmarrjen transparente të publikut dhe të përfshijë vlerësimet publike lidhur me ndikimet e mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore. Me këtë ligj po ashtu duhet të sigurohet

pjesëmarrja e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, ndërkohë që të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor duhet të përmbajnë raportin e shqyrtimit të propozimeve dhe vërejtjeve publike dhe peticioneve nga pronarët e tokave.<sup>12</sup>

MMPH me akt të veçantë respektivisht me Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor ka përcaktuar përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, njoftimit publik, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të debatit publik, trajtimin e peticioneve, si dhe përgatitjen e raportit shqyrtues të propozimeve dhe vërejtjeve publike. Udhëzimi Administrativ i MMPH Nr. 05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor përcakton parimet për organizimin e prezantimeve, shqyrtimit publike dhe të gjitha formave tjera të pjesëmarrjes publike për dokumentet e planifikimit hapësinor si dhe cakton mënyrën e nxitjes së publikut në procesin e planifikimit hapësinor. Ky UA rregullon edhe procedurat e pjesëmarrjes publike nga fillimi dhe përgjatë të gjitha fazave të procesit të planifikimit hapësinor si dhe përcakton përmbajtjen e raportit të shqyrtimit publik bazuar në procesverbalet nga takimet e mbajtura. Ligji për Ndërtim rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit. Në nenin 17 të këtij ligji shkruan se “planet rregullative urbane janë dokumente publike dhe çdo person duhet të ketë qasje në to përmes

<sup>12</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ligji për Planifikimin Hapësinor, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

ueb-faqeve komunale apo përmes kërkesës së palës”.<sup>13</sup>

## **Analizë e gjendjes në komunitat e rajonit të Prizrenit**

Pjesëmarrja e publikut në hartim të dokumenteve të planifikimit siguron që plani të jetë i qëlluar. Në të njëjtën kohë duke marrë pjesë në hartim të dokumenteve të plani kimit, publiku mishërohet me planin, e ton ndjenjën e pronësisë mbi planin si dhe angazhohet më shumë në zbatimin e tij. Në një hulumtim të EC Ma Ndryshe dhe Pro-Planning të vitit 2016,<sup>14</sup> në pyetjen se si e vlerësojnë pjesëmarrjen e publikut, 77% e të intervistuarve kanë deklaruar se ajo është e pamjaftueshme, ndërsa vetëm 23% deklarojnë se ajo është e mirë. Arsyet kryesore të pjesëmarrjes së pamjaftueshme dalin që janë: Mungesa e interesimit të publikut për të marrë pjesë në takimet e organizuara nga komuna dhe Mosinformimi adekuat dhe mungesa e qasjeve proaktive nga ana e komunës. Në lidhje me atë se cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë organizimit të aktiviteteve të pjesëmarrjes publike, gati gjysma e komunave kanë deklaruar se sfida më e madhe është sigurimi i pjesëmarrjes së kënaqshme, ndërsa dy nga komunitat kanë deklaruar se sfida është edhe informimi adekuat dhe efektiv i publikut, sepse qytetarët shpesh nuk lexojnë shpalljet komunale apo nuk ndjekin TV lokale, ku shpallen ftesat për debatet publike. Kthimi i besimit të humbur të qytetarëve, OJQ-të joaktive dhe pak të angazhuara në këtë drejtim, Mungesa

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Udhëzimi Administrativ për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10226>

<sup>14</sup> EC Ma Ndryshe dhe Pro-Planning, Sfidat e Planifikimit dhe Menaxhimit Hapësinor në Komuna, 2016 - [https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335\\_EC\\_PRO\\_Analiza\\_SHQ.pdf](https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335_EC_PRO_Analiza_SHQ.pdf)

e buxhetit për të organizuar takime dhe interesim i ultë i komunitetit profesional janë faktorë që vështirësojnë organizimin e aktiviteteve të pjesëmarrjes publike, edhe në rastet kur ekziston vullneti nga komuna.

#### *Niveli i pjesëmarrjes qytetare në hartimin e dokumenteve hapësinore*

Zyrtarët e komunave të rajonit të Prizrenit konstatojnë pjesëmarrje jo të kënaqshme të publikut në diskutimet publike për hartimin e dokumenteve hapësinore. Megjithatë, ata vërejnë edhe tregues të qartë të përmirësimit të gjendjes, sidomos në fazat më të vonshme të zhvillimit të një politike, ose në fazën e zbatimit të tij. Nivel të ultë të pjesëmarrjes publike në këtë sektor kanë konstatuar dy zyrtarët e Komunës së Sukarekës. Sipas drejtorit të shërbimeve publike të kësaj komune, Enver Shabani, pjesëmarrja vazhdon të jetë shumë e ultë,<sup>15</sup> ndërsa për drejtoret e urbanizmit, Sanije Kuqi, vërehet një përmirësim, pasi që qytetarët vetë kanë filluar të kuptojnë rëndësinë e përfshirjes me kohë në hartimin e planeve.<sup>16</sup> Një pasqyrë pak më optimiste ofron drejtori i urbanizmit në Komunën e Prizrenit, Fatmir Memaj. Sipas tij, pjesëmarrje e qyteatrëve është në masën e duhur.<sup>17</sup>

Perspektive e niveli qendror konfirmon trendin lokal. Sipas drejtorit të Institutit Hapësinor të Kosovës, Luan Nushi, “edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e performancës, pjesëmarrja publike është ende në nivel shumë të ulët. Gjithashtu, ai konstaton se “interesimi është shumë selektiv, në rastet më të mira pjesëmarrës janë vetëm qytetarët që ndikohen drejtpërdrejtë nga plani përkatës. Mungon ndjenja dhe interesimi për të përgjithshmen, për hapësirat që na takojnë dhe na bashkojnë të gjithëve. Fatkeqësisht ende po

---

<sup>15</sup> Intervistë me Enver Shabanin, drejtor i shërbimeve publike, Komuna e Sukarekës

<sup>16</sup> Intervistë me Sanije Kuqin, drejtoreshë e urbanizmit, Komuna e Sukarekës

<sup>17</sup> Intervistë me Fatmir Memajn, drejtor i urbanizmit, Komuna e Prizrenit

vazhdon interesim vetëm për ‘oborrin’ tonë.”<sup>18</sup> E njëjta konfirmohet edhe nga aktivistë të shoqërisë civile në komunat e rajonit të Prizrenit. Elmedina Dorambari nga Instituti Demokratik i Kosovës sheh një vullnet për t’i privuar qytetarët nga kjo e drejtë, duke konstatuar se komunat i konsultojnë qytetarët vetëm në fund të procesit të hartimit të një dokumenti të planifikimit hapësinor.<sup>19</sup> Mungesë interesimi të qytetarëve, si rezultat edhe i mungesës së besimit në institucione publike vëren Jeton Qengaj nga organizata Avoko në Dragash.<sup>20</sup> Aktivisti i të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, Nexhip Menekshe tërheq vëmendjen në rastet kur edhe përkundër pjesëmarrjes, mundësia për të ndikuar dhe formësuar dokumentet dhe politikat përkatëse mbetet tejte e vogël për qytetarët.<sup>21</sup>

Në komunat e rajonit të Prizrenit, publiku është pjesërisht i informuar sa i përket akteve normative dhe dokumenteve strategjike në fushën e planifikimit urban. Informatat janë të pakta mbi rregulloret ekzistuese për planifikim urban, planet, strategjitë, kriteret e kufizimet dhe procesin e marrjes së lejeve. Nuk ka informacion të mjaftueshëm në ueb faqet e komunave për Hartën Zonale dhe planet rregulluese të hollësishme. Komunat e rajonit të Prizrenit nuk përdorin mjete të avancuara për t’i mundësuar publikut vëzhgimin e të gjitha elementeve që ndërlidhen me planet urbane. Leximi i tyre kërkon njohuri profesionale. Nuk ka harta interaktive me informata mbi shërbimet, aktivitetet dhe resurset në territor, planet për mbrojtje të mjedisit dhe menaxhimin e resurseve natyrore, kualitetin e ujit në hapësira të caktuara, emitimin e gazrave, informata të sakta të destinimit të tokës. Komunat e rajonit të Prizrenit nuk janë mjaftueshëm transparente

---

<sup>18</sup> Intervistë me Luan Nushin, drejtor i Institutit Hapësinor të Kosovës

<sup>19</sup> Intervistë me Elmedina Dorambarin, Instituti Demokratik i Kosovës, Prizren

<sup>20</sup> Intervistë me Jeton Qengajn, Organizata Avoko, Dragash

<sup>21</sup> Intervistë me Nexhip Menekshen, drejtor ekzekutiv i organizatës Durmish Asllano, Prizren



lidhur me lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimin e hapësirave. Nuk publikohen listat me leje e ndërtimit të lëshuara, as vendimet dhe arsyetimet për lejet e ndërtimit të lëshuara. Procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve që kanë aprovuar lejet e ndërtimeve nuk janë të qasshme për publikun. As nuk ofrohen informata mbi përputhshmërinë e lejeve të lëshuara me planet aktuale të komunës.

#### *Grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit*

Sipas zyrtarëve të komunave që janë intervistuar në këtë hulumtim, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë vazhdojnë të kenë më së paku qasje në procese vendimmarëse që lidhen me planifikimin urban. Sipas drejtores së urbanizmit në Komunën e Suharekës, Sanije Kuqi, “pjesëmarrja në diskutime publike normalisht i përket të gjitha kategorive apo grupeve të interesit, por nga takimet e mbajtura mund të konstatojmë se në këto takime dominon në përgjithësi mosha e mesme e gjinisë mashkullore”.<sup>22</sup> Përfshirja më e gjërë e këtyre grupeve mund të sigurohet duke përdorë teknika specifike të përfshirjes, të dizajnuara për këto grupe duke pasë në konsideratë karakteristikat e tyre. Sipas drejtorit të Institutit Hapësinor të Kosovës, “ky proces kërkon përkushtim dhe aftësi komunikative të zyrtarëve të ngarkuar me këtë detyrë dhe në disa raste ka implikime financiare shitesë (transporti për PAK, të moshuarit, etj.)” Sipas tij, në pak raste përfshirja e këtyre grupeve është realizuar përmes përkrahjes së donatorëve.<sup>23</sup>

Nivel të lartë të përjashtimit social nga proceset e planifikimit hapësinor në komunat e rajonit të Prizrenit konstatojnë edhe aktivistët e shoqërisë civile. Sipas Elmedina Dorambarit nga KDI Prizren, gratë dhe të rinjtë janë ndër kategoritë me të përjashtuara,<sup>24</sup> ndërsa për aktivistin

<sup>22</sup> Intervistë me Sanije Kuqin, drejtoreshë e urbanizmit, Komuna e Suharekës

<sup>23</sup> Intervistë me Luan Nushin, drejtor i Institutit Hapësinor të Kosovës

<sup>24</sup> Intervistë me Elmedina Dorambarin, Instituti Demokratik i Kosovës, Prizren

Nexhip Menekshe, edhe në rastet kur sigurohet pjesëmarrje e grupeve të nënpërfaqësuar në diskutime publike, zëri i tyre përgjithësisht mbetet i padëgjuar dhe komentet e sugjerimet që vijnë nga ta shpesh as nuk dokumentohen nga zyrtarët e komunave.<sup>25</sup>

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së për herë të parë bënë një referencë të qartë dhe identifikuan si një ndër 17 objektivat “përfshirjen, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore”. Pika e referencës është vendosur në vitin 2030, kur, ndër të tjera, hapësirat publike duhet të jenë të sigurta, gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe të gjelbra, veçanërisht për gratë, fëmijët, personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara.<sup>26</sup> Në anën tjetër, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi dokumentin Habitat III (konferencë në Quito) për zhvillimin e qëndrueshëm urban. Habitat III përcakton një vizion ambicioz, ku qytetet dhe vendbanimet njerëzore: përmesh funksionin e tyre shoqëror, janë pjesëmarrës dhe nxisin angazhimin qytetar, vendosin prioritetet për hapësira publike të sigurta, gjithëpërfshirëse, të arritshme, të gjelbra dhe cilësore, fuqizojnë gratë dhe eliminojnë diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin e kështu me radhë.<sup>27</sup> Praktika aktuale e qeverisjes urbane në qytetet e Kosovës nuk përmësh parimet ndërkombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm, të përqendruar tek njerëzit, mosha dhe gjinia dhe infrastruktura e integruar urbane.

Autoritetet planifikuese në komunat e rajonit të Prizrenit kanë nevojë për mbështetje për forcimin e qeverisjes urbane dhe krijimin e institucioneve dhe mekanizmave të shëndosha për të nxitur pjesëmarrjen e publikut në planet

<sup>25</sup> Intervistë me Nexhip Menekshen, drejtor ekzekutiv i organizatës Durmish Asllano, Prizren

<sup>26</sup> United Nations, Sustainable Development Goals, at <http://ëëë.un.org/sustainabledevelopment/>

<sup>27</sup> United Nations, Neë Urban Agenda (Habitat III), at <https://ëëë2.habitat3.org/bitcache/99d99fbd0824de50214e99f864459d8081a9be00?vid=591155&disposition=inline&op=vieë>

zhvillimore urbane që do të mundësonin dhe përshpejtonin përfshirjen sociale, rritjen e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit.

#### *Performansa e komunave në krijimin e mekanizmave dhe nxitjen e pjesëmarrjes*

Zyrtarët e intervistuar në kuadër të këtij hulumtimi kanë përmendur këto forma dhe mekanizma të përdorura nga ta për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në planifikimin urban: diskutime publike, shpërndarje informacione përmes mediave (TV, radio, gazetë), shtyje dhe shpërndarje e broshurave informative, njoftime të shpërndara përmes mediave sociale, shpërndarje e letrave informuese në lokalitetet për të cilat bëhet planifikimit, dërgimi e ftesave derë më derë, ekspozimi i planeve në hapësira të komunës dhe në objekte publike të lagjes. Megjithatë, reagimi mbetet në nivel jo të kënaqshëm. Drejtorja e urbanizmit në komunën e Suharekës, Sanije Kuqi, përmend një rast ilustrues, ku përkundër 600 ftesave të dërguara në adresë shtëpie, në diskutimin përkatës publik kishin ardhur vetëm rreth 40 qytetarë.<sup>28</sup>

Gjendje e njëjtë është shfaqur edhe gjatë hartimit të dokumenteve qendrore të planifikimit hapësinor. Sipas drejtorit të IHK, Luan Nushi, gjatë procesit të hartimit të Planit Hapësinor të Kosovës janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për thirrje në pjesëmarrje (gazetat ditore, TV, Radio, rrjetet sociale, etj.), por fatkeqësisht përgjigja ka qenë nën pritjet e tyre. Ai vëren se numri i pjesëmarrësve në këto procese në nivel komunal është shumë i vogël, dhe se në rastet më të mira, një pjesë e konsiderueshme e të ftuarve zëvendësohen me pjesëmarrës jo kompetent, të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë përmbajtjen.<sup>29</sup> Drejtori i IHK rendit arsytet që sipas tij janë shtaktare të këtij

realiteti: niveli jo i duhur i përgjegjshmërisë së zyrtarëve, paaftësia në aspektin organizativ, buxheti i pamjaftueshëm për konsultime, mosardhja e vendimmarrësve në diskutime, mënyra joadekuate e njoftimit publik, dhe humbja e besimit qytetar në institucione.

Aktivistët e shoqërisë civile janë kritikë sidomos ndaj faktit që komunat nuk marrin mundin të dalin jashtë kornizave konvencionale të organizimit të diskutimeve publike, duke u kufizuar në metoda standarde të njoftimit. Kjo sipas Elmedina Dorambarit nga KDI Prizren nënkupton që komunat kanë dështuar që qytetarët t'i bënë hisedarë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit urban. Ajo gjithashtu vëren se në projekte të shoqërisë civile të përkrahura nga donatorë të jashtëm rëndom pjesëmarrja e qytetarëve është e lartë.<sup>30</sup> Ky është një tregues që përdorimi i qasjeve dhe materodave alternative mund të prodhojë efektin e duhur në arritjen e gjithëpërfshirjes. Aktivisti i shoqërisë civile, Nexhip Menekshe nga Durmish Asllano vëren edhe një të metë sistimore, atë të mungesës së një mekanizmi monitorimi nëse kërkesat e paraqitura nga qytetarët janë adresuar në një fazë të mëvonshme nga institucionet publike.<sup>31</sup>

#### *Roli i organizatave të shoqërisë civile në nxitjen e bashkëqeverisjes*

Bashkëpunimi mes komunave (autoriteteve të planifikimit) dhe organizatave të shoqërisë civile në komunat e rajonit të Prizrenit nuk është në nivelin e duhur. Rëndom zyrtarët e planifikimit hapësinor në komuna presin angazhim më të madh të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa këta të fundit shprehin skepticizëm në raport me rezultatet e prekshme që mund të arrihen nga ky bashkëpunim. Në rastin e Komunës së Prizrenit, sipas Elmadina Dormnarit nga KDI Prizren, "organizatat e shoqërisë civile janë mjaft aktive në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në

<sup>28</sup> Intervistë me Sanije Kuqin, drejtoreshë e urbanizmit, Komuna e Suharekës

<sup>29</sup> Intervistë me Luan Nushin, drejtor i Institutit Hapësinor të Kosovës

<sup>30</sup> Intervistë me Elmedina Dorambarin, Instituti Demokratik i Kosovës, Prizren

<sup>31</sup> Intervistë me Nexhip Menekshen, drejtor ekzekutiv i organizatës Durmish Asllano, Prizren

proceset e planifikimit urban. Aktivizimi qytetar dhe avokimi për interes të grupeve qytetare me qëllim të përfshirjes së tyre në hartimin e planeve rregulluese janë kryesisht fokusi i angazhimit të disa organizatave të shoqërisë civile.”<sup>32</sup> Mirëpo, në komunat e tjera ku numri i organizatave aktive nuk është i madh, ky bashkëpunim është më i vështirë. Mungesë bashkëpunimi mes komunës dhe shoqërisë civile konstaton edhe Jeton Qengaj nga organizata Avoko në Dragash, pasi sipas tij përveç numrin të vogël të organizatave që veprojnë në këtë komunë, ato vazhdojnë të përballen edhe me vështirësi financiare.<sup>33</sup>

#### *Përkrahja nga niveli qendror dhe donatorët*

Komunat deklarojnë se kanë pranuar ndihmë teknike nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në raport me proceset e planifikimit në nivel komune. Megjithatë, në raport me nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në planifikim vërehet mungesë e iniciativës nga të dyja palët, me përjashtim të bazës ligjore që është krijuar me angazhim të nivelit qendror. Deri më tani sipas përvojës së drejtorit të Institutit Hapësinor të Kosovës, forma konkrete e përkrahjes është nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për pjesëmarrje publike në procesin e planifikimit hapësinor dhe urban. Formë tjetër, sipas tij, është “kërkesa e vazhdueshme drejtuar autoriteteve komunale, që në kuadër të procesit të planifikimit hapësinor, duhet të parashihet dhe të dëshmohet formalisht përfshirja e publikut në proces.” Interesimi i komunave në anën tjetër, sipas drejtorit të IHK ky interesim ka qenë i ulët, janë vetëm pak komuna që e kanë shfrytëzuar këtë mundësi.<sup>34</sup> Organizatat e shoqërisë civile raportojnë për një gjendje të rënduar financiare, pasi që tema e planifikimit hapësinor nuk gjendet lart në axhendën e donatorëve të jashtëm. Një pjesë e mirë e

organizatave me bazë në komunitet, dhe sidomos ato që përfaqësojnë grupet e nënpërfaqësuar, si pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuara, gratë he vajzat, të moshuarit, vazdojnë të përballen me sfida të qëndrueshmërisë institucionale dhe financiare.

#### **Rekomandime**

EC Ma Ndryshe është e angazhuar një kohë të gjatë në nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procese të vendimmarrjes në nivel lokal, më theks në planifikim dhe zhvillim urban. Organizata monitoron në vazhdimësi këtu procese dhe ofron alternative të politikave publike, si dhe rekomandon metodologji dhe mekanizma alternativë për të nxitur gjithëpërfshirjen në planifikimin dhe zhvillimin e mjedisit jetoësor në komunat e Kosovës. EC Ma Ndryshe rekomandon këto veprime si më prioritare dhe urgjente:

- Komunat duhet të sfidojnë veten duke futur në përdorim edhe metoda kreative të informimit publik dhe përfshirjes së tyre në procese të planifikimit hapësinor
- Qytetarët duhet vazhdimisht të informohen mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në procese të planifikimit hapësinor në mënyrë që të jetë në gjendje të japin kontribut substancial dhe të kuptojë përfitimet e tyre nga përfshirja në planifikim
- Kur vendoset të zhvillohet ndonjë proces i planifikimit hapësinor, paralel me buxhetin për hartim/zbatim, duhet të alokohet edhe buxheti për pjesëmarrjen publike në atë proces, në mënyrë që kjo të mos pamundësojë pjesëmarrjen e nevojshme dhe të kënaqshme

<sup>32</sup> Intervistë me Elmedina Dorambarin, Instituti Demokratik i Kosovës, Prizren

<sup>33</sup> Intervistë me Jeton Qengajn, Organizata Avoko, Dragash

<sup>34</sup> Intervistë me Luan Nushin, drejtor i Institutit Hapësinor të Kosovës

- Duhet të përmirësohet performanca e komunave në zbatim të planeve në mënyrë që të kthehet besimi i qytetarëve dhe motivimi i tyre për pjesëmarrje.
- Organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen më shumë për të prioritetizuar çështjet e planifikimit hapësinor dhe të nxisin mobilizimin qytetar për gjithëpërfshirje në qeverisje urbane

## Burime

### *Legjislacion, Politika*

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Kosovës, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzimi Administrativ për Transparencën në Komuna, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11403>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Udhëzimi Administrativ për Ueb faqet e Institucioneve Publike, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11007>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ligji për Planifikimin Hapësinor, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Udhëzimi Administrativ për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikim Hapësinor, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10226>

### *Raporte, Analiza*

Madanipour, Ali, (2003) *Public and Private Spaces of the City*, Routledge

Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), *The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces*, MIG Communications).

Përkufizim i Shoqatës Amerikane të Planifikimit, i publikuar në: <https://www.planning.org/aboutplanning/whatisplanning.htm>

Urban trends, BMW Guggenheimlab, <http://www.bmwguggenheimlab.org/100urbantrends/#!/new-york-city>

EC Ma Ndryshe dhe Pro-Planning, Sfidat e Planifikimit dhe Menaxhimit Hapësinor në Komuna, 2016 - [https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335\\_EC\\_PRO\\_Analiza\\_SHQ.pdf](https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/160530170335_EC_PRO_Analiza_SHQ.pdf)

### *Intervista*

Enver Shabani, Drejtor, Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Energjencë, Komuna e Suharekës, intervistuar më 15.10.2018

Fatmir Memaj, Drejtor, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Komuna e Prizrenit, intervistuar më 02.11.2018

Sanije Kuqi, Drejtoreshë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, Komuna e Suharekës, intervistuar më 13.11.2018

Luan Nushi, Drejtor, Instituti i Planifikimit Hapësinor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, intervistuar më 25.10.2018

Jeton Qengaj, drejtor ekzekutiv, OJQ Avoko, Dragash, intervistuar më 15.11.2018

Elmedina Dorambari, monitoruese, Instituti Demokratik i Kosovës, Prizren, intervistuar më 29.10.2018

Nexhip Menekshe, drejtor ekzekutiv, OJQ Durmish Asllano, Prizren, intervistuar më 15.10.2018

### **EC Ma Ndryshe**

EC angazhohet për qytete/komuna gjithëpërfshirëse në Kosovë. Organizata beson në vlerën e shtuar që sjell angazhimi i gjithësecilit në qeverisjen e qyteteve/komunave dhe në veçanti e atyre që kanë më pak qasje dhe mundësi për të ndikuar. Në punën e saj 12 vjeçare EC është fokusuar në mobilizimin e komunitetit duke u dhënë prioritet grupeve të nënpërfaqësuar. Ky angazhim e ka vendosur EC-in në krye të organizatave të komunitetit në Kosovë. Një nga metodologjitë dalluese të EC-it është ajo e planifikimit urban me pjesëmarrje, rezultatet e së cilës janë tejet të prekshme në komunën e Prizrenit. Brenda grupeve të komunitetit, EC ka përvojë shumë të gjatë të angazhimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe ka ndërtuar një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh, përfshi organizata dhe grupe që përfaqësojnë intereset e PAK. Si rezultat i këtij angazhimi, një numër pengesash fizike janë mënjanuar në hapësira të ndryshme publike të Prizrenit, duke përmirësuar mobilitetin e përgjithshëm.

Për shumë qytetarë të Prizrenit, por edhe për disa lokacione të tjera në Kosovë, EC shihet si adresë shumë kredibile për çuarjen tutje të nevojave, kërkesave dhe interesave komunitare. EC ka punuar dhe vazhdon të punojë ngushtë me PAK, të moshuarit, gratë dhe vajzat, banorët e lagjeve informale, komunitetet joshumicë, artistët, ambientalistët dhe shumë të tjerë në baza ditore në përpjekjen e përbashkët për t'i kthyer nevojat e qytetarëve në vendime e veprime të institucioneve. Në të njëjtën kohë, EC ka ndërtuar grupe lokale të komunitetit në nivel të lagjes dhe fshatit në komunën e Prizrenit, ndërsa nga viti 2018 këtë praktikë po e bart edhe në komunat e tjera të Kosovës (deri në 2020 synohet zgjerimi deri në dhjetë komuna). Përveç angazhimit komunitar, EC njihet edhe për avokimin konsistent

në mbrojtje të strukturës urbane të qyteteve të Kosovës, me fokus në vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Përmes rrjetit të gjerë të profesionistëve me të cilët bashkëpunon në baza të rregullta, EC ka zhvilluar standarde të larta të cilësisë sa i përket shërbimeve që i ofron dhe produkteve që i realizon. Organizata ka qenë dhe vazhdon të jetë kontribuese e drejtpërdrejtë e hartimit të një numri të konsiderueshëm politikash publike në nivel qendror dhe lokal. Në të njëjtën kohë, EC ka prezencë të shtuar edhe rajonale dhe ndërkombëtare përmes mekanizmave të rëndësishëm të rrjetëzimit profesional dhe të shoqërisë civile.

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).



Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, përkrahur financiarisht nga Olof Palme International Center, e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë.